Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

# VENDIM

**Data e miratimit: 9 qershor 2011**

**Lënda nr. 47/08**

**Fillim GUGA**

**kundër**

**UNMIK-ut**

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i mbledhur më 9 qershor 2011,
me anëtarët vijues të pranishëm:

Z. Marek NOWICKI, Kryetar
Z. Paul LEMMENS
Znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga
Znj. Anila PREMTI, Ushtruese detyre e zyrtares ekzekutive

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, të paraqitur në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas diskutimeve vendosi si në vijim:

## I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa u paraqit më 3 nëntor 2008 dhe u regjistrua më 13 nëntor 2008. Më 19 mars 2009, ankuesi paraqiti informacione shtesë. Ankesa u paraqit pranë Panelit nga z. Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

2. Më 8 prill 2009, Paneli kërkoi informacione nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit.

3. Më 27 korrik 2009, Paneli i dërgoi një kërkesë shtesë Dhomës së Posaçme. Më 30 korrik 2009, Dhoma e Posaçme e ofroi përgjigjen e saj.

4. Më 17 shtator 2009, Paneli kërkoi informacione shtesë nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) në cilësinë e tij si përfaqësues i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM).

5. Më 25 nëntor 2009, Paneli e përsëriti kërkesën drejtuar PSSP-së për informacione. Më 4 dhjetor 2009, PSSP-ja dha përgjigjen e tij.

6. Më 13 janar 2010, Paneli kërkoi informacione shtesë nga ankuesi. Më 24 janar 2010, ankuesi ofroi një përgjigje të pjesshme dhe më 5 shkurt 2010, ai e dha përgjigjen e tij të plotë.

7. Më 29 prill 2010, Paneli ia komunikoi ankesën PSSP-së për komentet e tij për pranueshmërinë e ankesës. Më 26 maj 2010, PSSP-ja e dha përgjigjen e tij.

8. Më 9 qershor 2010, komentet e PSSP-ë iu dërguan ankuesit për të dhënë përgjigje. Ankuesi dha përgjigjen e tij më 19 korrik 2010.

## II. FAKTET

9. Ndërmarrja në pronësi shoqërore (NPSH) KNI "Dukagjini" OTHPB-BP IMN Tjegulltorja ("IMN") fillimisht e punësoi ankuesin si punëtor të përkohshëm më 16 prill 1979, vend pune të cilin ai e mbajti deri më 31 gusht 1979. IMN e ri-punësoi ankuesin me kontratë të përhershme më 20 qershor 1980. Ai punoi për IMN rreth 20 vite. Në librezën e tij të punës shënohet 23 mars 1999 si ditë e fundit e punësimit të tij në IMN. Mirëpo, sipas vendimit të IMN nr. 185 të datës 24 gusht 2000 me të cilin ndërpritet punësimi i tij (shih më poshtë, § 11), dita e fundit e punësimit të tij është 17 qershor 1999.

10. Më apo rreth 1 korrikut 1999, babai i ankuesit u zhduk. Së bashku me anëtarët e familjes së tij, ankuesi shkoi në Mal të Zi nga frika për sigurinë e tij. Më vonë, shtëpia e ankuesit ishte djegur dhe babai i tij ishte gjetur i vdekur.

11. IMN e ndërpreu punësimin e ankuesit me vendimin nr. 185 të datës 24 gusht 2000 për shkak të mosparaqitjes në punë për një periudhë të zgjatur pa justifikim. Me këtë vendim u ndërpre marrëdhënia e punës për 27 punëtorë të IMN, duke përfshirë edhe ankuesin. Derisa punëtorët të cilët ishin larguar paraqitën arsyetime për mungesën e tyre (të cilat ishin refuzuar për arsye të ndryshme), ankuesi bënte pjesë në grupin e punëtorëve për të cilët supozohej se janë jashtë vendit dhe nuk mund të kontaktoheshin nga IMN lidhur me procedurën. Në vendim gjithashtu thuhej: "Duke marrë parasysh rrethanat të cilat mbizotëruan në Kosovë, IMN nuk ndërmori asnjë procedurë disiplinore para një viti pas luftës, por meqë punëtorët e lartcekur nuk u paraqitën fare, [ata] parimisht nuk u deklaruan se dëshirojnë të vazhdojnë punën, kurse ndërmarrja duhet të vazhdojë të funksionojë me rregull, dhe ata duhet të zëvendësohen me punëtorë të ri." Vendimi ishte vendosur në tabelën e shpalljeve të fabrikës.

12. Pas kthimit të ankuesit në Kosovë në vitin 2001, ai e vizitoi IMN dhe kërkoi që t'i lejohet të rifillojë punën. Kërkesa e tij u refuzua. Ankuesi kishte kërkuar formalisht me shkrim të kthehet në punë më 8 prill 2002 dhe sërish më 12 mars 2003. Të dy kërkesat sërish u refuzuan. Prandaj, ankuesi parashtroi kërkesë pranë Gjykatës Komunale në Gjakovë duke kërkuar kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës në IMN. Më 16 shkurt 2004, gjykata komunale e refuzoi kërkesën e tij, duke konsideruar se procedura që shpuri tek ndërprerja e marrëdhënies së punës së ankuesit ishte bërë në pajtim me ligjin. Ankuesi parashtroi ankesë ndaj këtij aktgjykimi por më 28 qershor 2006 gjykata e qarkut në Pejë e hodhi poshtë ankesën e tij, u pajtua me arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e

certifikoi aktgjykimin e gjykatës më të ulët. Ankuesi pastaj parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës. Më 11 tetor 2007, Gjykata Supreme e Kosovës e hodhi poshtë ankesën e tij dhe e mbështeti aktgjykimin e gjykatës së qarkut. Gjykata Supreme konsideroi se sipas ligjit në fuqi në atë kohë, nuk kërkoheshin procedura formale për shkëputjen e marrëdhënies së punës për mungesa të shumta të palejuara nga puna.

13. Në ndërkohë, IMN u privatizua më 31 korrik 2006. Më 10 prill 2007 Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) publikoi listën provizore të stafit të cilët kishin të drejtë në një përqindje të fitimeve nga privatizimi. Ankuesi nuk u përfshijë në këtë listë.

14. Ankuesi paraqiti kërkesë në AKM, e cila u pranua më 5 mars 2007, duke argumentuar se ka mundur të përfshihet në listën provizore. Ai theksoi se në vitin 1999 ai frikësohej të qëndronte në Gjakovë. Ai tha se shtëpia e tij ishte djegur dhe se pas kthimit të tij në Kosovë në vitin 2001, shtëpia e tij ishte rindërtuar nga një OJQ. Ankuesi gjithashtu theksoi: "Unë isha refugjat në Mal të Zi dhe kam qëndruar në Kotor nga ku nuk kam mundur të paraqitem në punë dhe më pastaj punëdhënësi më ka larguar nga puna." Ai tha se është paraqitur në punë pas kthimit, por se IMN kishte refuzuar ta kthej në pozitën e mëparshme. Ai në veçanti tha: "Unë jam përpjekur të realizoj të drejtat e mia përmes procedurës gjyqësore por pa sukses meqë më thanë se jam paraqitur në punë shumë vonë. Ndjehem se jam i diskriminuar meqë i përkas komunitetit egjiptian."

15. Më 26 mars 2008 KTA e publikoi listën përfundimtare të punëtorëve të cilët kishin të drejtë në një pjesë të fitimeve nga IMN, ashtu siç ishte miratuar nga Bordi i Drejtorëve të AKM-së.[1] Ankuesi nuk ishte në listën e publikuar.

16. Më 11 prill 2008, ankuesi paraqiti peticion në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës kundër vendimit të formës së prerë të Bordit të Drejtorëve të AKM-së. Ai pohon se kontrata e tij u shkëput në mungesë të tij për shkak të diskriminimit të tij si pjesëtar i komunitetit pakicë. Ai pohoi se serbët etnikë të cilët nuk ishin paraqitur në punë pas 10 qershorit 1999 për arsye të sigurisë ishin të përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë në një pjesë të fitimeve nga privatizimi. Prandaj ai ankohet se është diskriminuar në krahasim me kolegët e tij serb. Ai kërkoi nga Dhoma e Posaçme të ndryshojë vendimin për përjashtimin e tij nga lista përfundimtare e stafit me të drejtë në fitimet e privatizimit. Ai nuk tregoi se kishte parashtruar kërkesë në gjykatat e rregullta duke kërkuar kthimin e tij në vendin e punës.

17. Më 29 prill 2008, Dhoma e Posaçme ia dërgoi atij përgjigjen e AKM-së lidhur me kërkesën e ankuesit. Në atë përgjigje, AKM-ja në veçanti theksoi se nuk kishte indikacion se ankuesi kishte parashtruar ankesë kundër vendimit për shkëputjen e marrëdhënies së tij të punës, apo se ai kishte tentuar të kthehet në pozitën e mëparshme. AKM-ja po ashtu theksoi se nuk kishte dëshmi se ankuesi kishte qenë viktimë e ndonjë diskriminimi në kuptim të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 të datës 9 maj 2003 mbi bartjen e së drejtës për shfrytëzim të pronës së paluajtshme shoqërore.

18. Në përgjigjen e tij të datës 12 maj 2008, ankuesi e identifikoi veten si refugjat politik i cili kishte shkuar në Mal të Zi për të ikur nga ndjekja prej disa grupeve nga Kosova. Ai, në veçanti, tha si vijon: "Babai im nuk erdhi me mua dhe qëndroi në Kosovë dhe u vra nga persona të panjohur, mbetjet mortore të të cilit u dërguan në Mal të Zi. Kjo ka mundur të më ndodhte edhe mua gjithashtu po të mos isha larguar nga Kosova." Ankuesi nuk kishte treguar se kishte parashtruar ankesë në gjykatat e rregullta për t'u rikthyer në punë.

---

[1] AKM-ja kishte publikuar një listë të mëhershme "Listë përfundimtare" që ishte anuluar nga Dhoma e Posaçme më 22 janar 2008, sepse ajo listë nuk ishte miratuar nga Bordi i Drejtorëve të AKM- së.

19. Në përgjigjen e datës 10 qershor 2008, AKM-ja theksoi se shumica e punëtorëve në IMN ishin joshqiptarë, ku përfshiheshin pjesëtarë të komunitetit rom/ashkali/egjiptas. AKM-ja argumentoi se edhe pse ankuesi ka mundur të ketë shkuar në Mal të Zi për një periudhë kohore, nuk duket se ka pasur shkaqe të arsyeshme për të supozuar se është bërë diskriminim.

20. Më 17 qershor 2008, Dhoma e Posaçme morri aktgjykimin e saj, duke refuzuar kërkesën si të pabazuar dhe duke deklaruar se ankuesi nuk i plotësonte kushtet për t'u përfshirë në listën për kompensim. Në pjesën relevante të aktgjykimit thuhet:

> Dhoma e [Posaçme] vepron në përputhje me standardet ligjore të parashikuara të Ligjin kundër diskriminimit [Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 2004/3 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/32 të datës 20 gusht 2004]. Parimi i paraqitur në nenin 8 të Ligjit kundër diskriminimit është ndryshe nga kërkesat për dëshmi dokumentare të paraqitura në nenin 10.6(b) të Rregullores së [UNMIK-ut] 2003/13.
>
> Ankuesit të cilët pretendojnë diskriminimin duhet të paraqesin fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim direkt apo të indirekt, në pajtim me nenin 8.1 të Ligjit kundër diskriminimit. Përveç kësaj, pasi ankuesi të paraqet një rast të diskriminimit direkt apo indirekt në shikim të parë, i padituri obligohet të hedhë poshtë diskriminimin.
>
> …
>
> [Ankuesi] ka punuar në NPSH [IMN] nga 1979 deri më qershor 1999. Ai konfirmoi se pas qershorit 1999 ai qëndroi në Mal të Zi për një periudhë të gjatë kohore për shkak të shqetësimeve nga gjendja e sigurisë, dhe pas kthimit të tij në Kosovë ai u përpoq të punësohet por u refuzua dhe kështu u diskriminua.
>
> I padituri e hedh poshtë ankesën e ankuesit duke u arsyetuar se punësimi i ankuesit u ndërpre me vendimin nr. 185/00 të datës 24.08.2000. Ai nuk inicioi padi civile kundër këtij vendimi për t'u kthyer në vendin e tij të punës.
>
> …
>
> Dhoma e Posaçme i ka shqyrtuar të gjitha dëshmitë dhe pajtohet me analizën e të paditurit [AKM]. Prandaj, Dhoma e Posaçme e hedh poshtë kërkesën e ankuesit për t'u përfshirë në listën e punëtorëve me të drejtë në fitimet e privatizimit.

21. Më 3 korrik 2008, ankuesi parashtro ankesë kundër këtij aktgjykimi, duke u mbështetur në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/4 të datës 5 shkurt 2008 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 për themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, ku përfshihej mundësia për të paraqitur ankesë kundër aktgjykimeve të Dhomës së Posaçme në një panel tjetër të Dhomës së Posaçme. Në ankesën e tij ai argumenton se Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2008/4 hyri në fuqi më 31 maj 2008, kurse Dhoma e Posaçme e nxori aktgjykimin e saj për lëndën e tij më 17 qershor 2008. Prandaj, ai pretendon se ka të drejtë në ankesë.

22. Dhoma e Posaçme e nxori vendimin e saj të dytë më 10 shtator 2008, duke refuzuar ankesën e ankuesit. Ajo konstatoi se Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2008/4 më vonë u

ndryshua me rregullore të cilat e shtynin hyrjen e saj në fuqi deri më 31 tetor 2008. Prandaj asnjë ankesë nuk ishte e mundur të paraqitet kundër aktgjykimit të datës 17 qershor 2008.

## III. ANKESA

23. Ankuesi ankohet se ai pa të drejtë është përjashtuar nga lista e punëtorëve gjatë privatizimit të IMN për shkak të prejardhjes së tij egjiptiane. Ai në veçanti ankohet se punëdhënësi i tij e diskriminoi atë duke mos e lejuar të kthehet në punë, se gjykatat e Kosovës e diskriminuan duke mos e mbështetur kërkesën e tij të kthehet në punë, dhe se AKM-ja dhe Dhoma e Posaçme e diskriminuan atë në procedurën për të kërkuar një pjesë të fitimeve nga privatizimi i ndërmarrjes për të cilën ai kishte punuar më parë duke e trajtuar atë ndryshe nga serbët etnikë të cilët kërkonin të përfshihen në listë në rrethana të ngjashme faktike. Ai po ashtu ankohet se Dhoma e Posaçme nuk i zbatoi dispozitat e Ligjit kundër diskriminimit (Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 2004/3 të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/32 të datës 20 gusht 2004).

24. Ankuesi argumenton se ka pasur shkelje të nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), lidhur me nenin 6 § 1 të KEDNJ (e drejta për gjykim të drejtë) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ (e drejta për gëzimin e papenguar të pronës). Paneli konsideron se ankesa po ashtu mund të ngre çështje sipas nenit 1 të Protokollit nr. 12 të o the ECHR.

25. Ai gjithashtu ankohet se i është mohuar qasja në gjykatat e themeluara sipas ligjit sepse ai nuk ka pasur mundësi të parashtrojë ankesë kundër vendimit të Dhomës së Posaçme sipas Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2008/4 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 për themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, duke shkelur nenin 6 § 1 të KEDNJ.

## IV. LIGJI

26. Para se të shqyrtohet rasti për bazueshmërinë e tij, Paneli së pari duhet të vendosë nëse do ta pranojë rastin, duke marrë parasysh kriteret për pranim të paraqitura në nenet 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

*A. Shkëputja e marrëdhënies së punës së ankuesit nga KNI "Dukagjini" OTHPB-BP IMN Tjegulltorja ("IMN") dhe procedurat e mëpastajme*

27. Ankuesi argumenton se është diskriminuar nga ish punëdhënësi i tij IMN meqë nuk i ishte lejuar që të kthehet në punë pas kthimit të tij në Kosovë. Ai gjithashtu argumenton se është diskriminuar në procedurat e mëvonshme duke kërkuar kthimin e tij në punë.

28. Paneli përkujton se, sipas nenit 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, ai ka juridiksion vetëm për "ankesat që kanë të bëjnë me pohimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut që kishin ndodhur jo më herët se 23 prill 2005 apo që dalin nga faktet që kanë ndodhur para kësaj date kur këto fakt paraqesin shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut". Paneli thekson se pohimi për çfarëdo aktesh diskriminuese që ka mundur t'i bëjë IMN kur ankuesi tentoi të kthehet në vendin e punës duke vizituar IMN personalisht në vitin 2001 apo përmes shkresave të tij të datës 8 prill 2002 dhe 12 mars 2003, janë akte të atypëratyshme, të cilët nuk paraqesin shkelje të vazhdueshme (shih Paneli Këshillëdhënës

për të Drejtat e Njeriut (HRAP), *Lajović*, nr. 09/08, vendim i datës 16 korrik 2008, § 7). Si rrjedhojë, kjo pjesë e ankesës është jashtë juridiksionit kohor të Panelit (*ratione temporis).*

29. Sa u përket procedurave të mëtejshme pranë Gjykatës Supreme, është e vërtetë se aktgjykimi i formës së prerë të Gjykatës Supreme ishte nxjerrë më 11 tetor 2007. Përderisa procedurave gjyqësore iu referohemi nga pikëvështrimi i diskriminimit të cilit pohohet se i është nënshtruar ankuesi nga IMN, këto procedura nuk mund të ndahen nga aktet në të cilat u bazua ankesa pranë Gjykatës Supreme. Në këtë kontekst, Paneli i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sa i përket juridiksionit të saj sipas KEDNJ:

> "… Juridiksioni kohor i gjykatës përcaktohet në lidhje me faktet themelore të ndërhyrjes së pohuar. Dështimi i mjeteve të mëvonshme që synuan trajtimin e ndërhyrjes nuk e përfshin çështjen në juridiksionin kohor të gjykatës" (GJEDNJ (Grand Chamber), *Blečič v. Kroacia*, nr. 59532/00, aktgjykim i 8 marsit 2006, § 77, GJEDNJ, 2006-III).

30. Si rrjedhojë, kjo pjesë e ankesës është jashtë juridiksionit kohor të Panelit (*ratione temporis)* (shih HRAP, *Gojković*, nr. 63/08, vendim i 4 qershorit 2009, §§ 24-25 dhe *Petrović dhe të tjerët*, HRAP nr. 59/08 dhe të tjerët, vendim i 9 shtatorit 2010, §§21-23.)

*B. Mohimi i së drejtës në fitimet e privatizimit të IMN*

*1. Diskriminimi i pohuar*

31. Ankuesi gjithashtu argumenton se ai është diskriminuar gjatë procedurave të zhvilluara pranë AKM-së dhe Dhomës së Posaçme, meqë ankuesit etnikë serb në pozitë të njëjtë sikurse ai kishin marrë një pjesë të fitimeve nga privatizimi. Ai thekson se po të kishte qëndruar në Kosovë pas 10 qershorit 1999, ai do të ishte i vrarë, sikurse i ati i tij, dhe prandaj u largua. Ai pretendon se AKM-ja i kishte njohur të drejtat e serbëve etnikë për të marrë një pjesë të fitimeve edhe pse personat e tillë nuk e kishin kontestuar shkëputjen e marrëdhënies së punës përmes procedurave gjyqësore për shkak të gjendjes së përgjithshme të sigurisë. Ai i ka siguruar emrat e katër personave për të cilët ai pohon se kanë pasur mundësi të marrin një pjesë të fitimeve pa pasur nevojë të kontestojnë statusin e tyre përmes një ankese në Dhomën e Posaçme.

32. Ankuesi gjithashtu argumenton se Dhoma e Posaçme e diskriminoi atë kur morri vendim për rastin e tij duke mos i respektuar dispozitat përkatëse të Ligjit kundër diskriminimit në procedurat e zhvilluara. Në veçanti, ankuesi citon nenin 8, ku në pjesën përkatëse të tij thuhet:

> 8.1. Kur personat të cilët konsiderojnë se u është bërë një padrejtësi për shkak të moszbatimit të parimit për trajtim të barabartë paraqesin fakte pranë një gjykate apo ndonjë autoriteti tjetër kompetent, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i padituri duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit për trajtim të barabartë.
>
> 8.2. Paragrafi 8.1 nuk e parandalon paraqitjen e administrimit të provave, të cilat janë më të favorshme për paditësit. Gjithashtu, ankuesi mund të paraqesë apo mbrojë rastin e tij të diskriminimit me çfarëdo mjetesh, duke përfshirë edhe të dhënat statistikore.

33. Ankuesi në thelb argumenton se ai paraqiti në shikim të parë një rast të diskriminimit, i cili rast nuk u hodh poshtë nga AKM ose nuk u sqarua me aktgjykimin e Dhomës së

Posaçme të datës 17 qershor 2008, duke rezultuar me trajtim diskriminues që është shkelje e nenit 14 të KEDNJ së bashku me të drejtën e tij në gjykim të drejtë të përfshirë në nenin 6 § 1 të KEDNJ.

34. UNMIK-u reagon duke thënë se ankuesi në asnjë fazë nuk ka dëshmuar me fakte relevante se është diskriminuar në krahasim me punëtorët tjerë në IMN. UNMIK-u argumenton se ankuesi nuk e njoftoi Dhomën e Posaçme se kishte parashtruar ankesë në gjykatat e rregullta për shkëputjen e marrëdhënies së punës, dhe ankuesi kishte treguar se ai qëllimisht nuk i kishte paraqitur informacionet e tilla meqë nuk i kishte konsideruar relevante në kontekstin e ankesës që e kishte paraqitur pranë Dhomës së Posaçme. Prandaj, UNMIK-u konkludon se Dhoma e Posaçme e ka marrë aktgjykimin duke u bazuar në shqyrtimin adekuat të dëshmive që i ka pasur në dispozicion, dhe se mosparaqitja e dëshmive relevante nga ankuesi që i ka pasur në dispozicion nuk mund të rezultojë me shkelje të nenit 14 të KEDNJ lidhur me nenin 6 të KEDNJ ose nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ. Bazuar në këtë që u tha më lart, UNMIK-u argumenton se ankesa në shikim të parë është e pabazuar.

35. Paneli nga ana e tij thekson se ankuesi paraqiti arsyet në të cilat u bazua ankesa e tij pranë Dhomës së Posaçme. Ai në veçanti pretendon se personat në situatë të ngjashme sikurse ai ishin trajtuar ndryshe bazuar në prejardhjen e tyre etnike, dhe se si rezultat ishte shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe e drejta për gëzim të papenguar të pasurisë së tij në formën e një pjese të fitimeve nga privatizimi. Për më tepër, ai pohon se derisa aktgjykimi i Dhomës së Posaçme i datës 17 qershor 2008 e përsërit argumentin e ankuesit se atij nuk i ishte lejuar të kthehet në punë duke u bazuar në diskriminimin, arsyetimi i mëvonshëm i Dhomës së Posaçme në shikim të parë nuk duket se e miraton zhvendosjen e barrës së dëshmisë ashtu siç kërkohet me Ligjin kundër diskriminimit. Edhe pse PSSP-ja jep vërejtjet e tij gjatë fazës së pranueshmërisë, Paneli konsideron se ankesat paraqesin çështje serioze faktike dhe juridike, vendosja e të cilave duhet të varet nga shqyrtimi i bazueshmërisë. Prandaj, Paneli konkludon se kjo ankesë nuk është e pabazuar në shikim të parë në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

36. Paneli nuk gjen arsye tjetër për ta shpallur këtë pjesë të ankesës të papranueshme.

*2. Mospranimi i ankesës së ankuesit*

37. Ankuesi thekson se Dhoma e Posaçme e shpalli ankesën e tij kundër aktgjykimit të 17 qershorit 2008 të papranueshme më 10 shtator 2008, edhe pse Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2008/4 e datës 5 shkurt 2008 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 për themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, kishte parashikuar të drejtën për ankesë kundër aktgjykimit të një paneli të Dhomës së Posaçme. Arsyeja pse nuk u lejua ankesa ishte se Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2008/4 akoma nuk kishte hyrë në fuqi, duke marrë parasysh shtyrjen e datës së hyrjes në fuqi me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/19 të datës 31 mars 2008, Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/29 të datës 31 maj 2008, dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/35 të datës 30 qershor 2008. Ankuesi mendon se me shtyrjen e hyrjes në fuqi të Rregullores me të cilën u krijua mundësia e parashtrimit të ankesës, UNMIK-u ia mohoi atij të drejtën për qasje në gjykatë duke shkelur nenin 6 § 1 të KEDNJ.

38. Është e vërtetë se Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/13 ishte zëvendësuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/4 të datës 5 shkurt 2008. Sipas Rregullores së mëvonshme, Dhoma e Posaçme është e përbërë nga pesë panele me nga tre gjyqtarë, të cilët dëgjojnë ankesat në shkallën e parë (neni 3.2). Është edhe paneli i apelit, i kryesuar nga kryetari i Dhomës së Posaçme dhe i përbërë nga pesë gjyqtarë, kompetent për dëgjimin e ankesave (neni 3.3). Neni 9.5 parasheh si vijon:

9.5 Aktgjykimi apo vendimi i panelit gjykues u dorëzohet palëve brenda tridhjetë (30) ditëve nga miratimi. Brenda tridhjetë ditëve nga pranimi, pala mund t'i parashtrojë ankesë panelit të apelit për rishqyrtim të aktgjykimit apo vendimit të tillë. Kur ndaj vendimit dhe aktgjykimit të marrë në pajtim me nenin 4.3 parashtrohet ankesë, paneli gjykues së pari vendos nëse vendimi apo aktgjykimi kundër të cilit është parashtruar ankesë meriton rishikim. Nëse paneli i apelit vendos të mos e rishikojë vendimin apo aktgjykimin e marrë në pajtim me nenin 4.3 të panelit gjykues, aktgjykimi apo vendimi i tillë merr formën e prerë. Kur paneli i apelit rishikon aktgjykimin apo vendimin mund të vendosë të konfirmojë, revokojë apo ndryshojë aktgjykimin ose vendimin e marrë nga paneli gjykues.

39. Neni 14 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2008/4 fillimisht parashihte që Rregullorja të hyn në fuqi më 31 mars 2008, "kur edhe rregullat procedurale të shpallura me nenin 7 do të përshtateshin ashtu si duhej". Mirëpo, kjo datë u ndryshua me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/19 të datës 31 mars 2008, "me qëllim të sigurimit të kohës shtesë që kërkohej për të bërë përshtatjen e duhur të rregullave procedurale të Dhomës së Posaçme të shpallura me nenin 7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13". Kështu, hyrja në fuqi e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2008/4 ishte shtyrë deri më 31 maj 2008. Paneli konstaton se neni 14 më vonë ishte ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/29 të datës 31 maj 2008, me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/35 të datës 30 qershor 2005 dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/36 të datës 1 nëntor 2008, çdo herë "me qëllim të sigurimit të kohës shtesë që është e nevojshme për krijimin e paneleve të specializuara të shkallës së parë dhe panelit të apelit në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit". Si rezultat, hyrja në fuqi e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2008/4 ishte shtyrë në mënyrë të suksesshme deri më 30 qershor 2008, 31 tetor 2008 dhe përfundimisht 31 dhjetor 2008.

40. Është e qartë nga sa u tha më lart se ankuesi nuk mund të mbështetej në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/4 kur ai parashtroi ankesë kundër aktgjykimit të Dhomës së Posaçme më 17 qershor 2008. Derisa ankuesi e parashtroi ankesën e tij më 3 korrik 2008, Paneli konstaton se, në kohën kur është dorëzuar aktgjykimi (17 qershor 2008), Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2008/4 akoma nuk kishte hyrë në fuqi, hyrja në fuqi e së cilës ishte paraparë më 30 qershor 2008 (shih Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/29 të datës 31 maj 2008). Prandaj, me shtyrjen e hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2008/4, UNMIK-u nuk e ka privuar ankuesin nga çfarëdo e drejte për të parashtruar ankesë, meqë një të drejtë të tillë ai akoma nuk e kishte fituar.

41. Për më tepër, ashtu siç konsideron edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6 i KEDNJ nuk garanton, si i tillë, të drejtën e ankesës ose të drejtën për shkallën e dytë të juridiksionit për çështje civile (shih p.sh., GJEDNJ, *Guérin v. Franca*, aktgjykim i 29 korrikut 1998, Raportet për aktgjykimet dhe vendimet 1998-V, § 44; GJEDNJ, *Marpa Zeeland b.v. dhe Metal Welding b.v. v. Hoalnda*, nr. 46300/99, aktgjykim i 9 nëntorit 2004, § 48). Paneli nuk sheh dispozitë në asnjërën nga instrumentet tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cekura në nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 e cila mund të kuptohej se garanton një të drejtë të tillë në raste të tjera që nuk janë penale. Me shtyrjen e hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2008/4, nuk mund të thuhet se PSSP-ja e ka shkelur ndonjë të drejtë fundamentale të ankuesit.

42. Paneli konstaton se kjo pjesë e ankesës është jokompatibile me të drejtat e njeriut të parashikuara në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cilave iu referohemi në nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, ose së paku nuk zbulon ndonjë formë të shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me këto instrumente. Si rrjedhojë,

kjo ankesë duhet hedhur poshtë si e pabazuar në shikim të parë në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së lartcekur (shih HRAP, *Krasnići*, nr. 20/08, vendim i 12 shtatorit 2009, §§ 37-44).

**PËR KËTO ARSYE,**

Paneli unanimisht,

- **SHPALL TË PRANUESHME ANKESËN LIDHUR ME DISKRIMINIMIN E POHUAR QË KA TË BËJË ME NDARJEN E FITIMEVE NGA PRIVATIZIMI I IMN;**

- **SHPALL TË PAPRANUESHME PJESËN TJETËR TË ANKESËS.**

Anila PREMTI
Ushtruese detyre e zyrtares ekzekutive

Marek NOWICKI
Kryetar